



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E ASETEVE DHE KADASTRES URBANE

Nr. 1456 Prot

Shkodër, më 28.01.2025

Lënda: Kërkesë për përfshirjen në rendin e dites të projekt vendimin: Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi, të pronave Ish Reparti Ushtarak Berdicë, Pasuria nr 10/127 dhe pasurinë në përgjegjësi të DPSHTRR nga prona shtetërore tek Bashkia Shkodër.

KESHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar këshilltarë, Referuar ligjit 139/2015 "Per veteqevcrisjen vendore" të ndryshuar, VKB nr.60, date 28,12,2020 "Për miratimin e Rregullores të organizimit dhe funksionimit të Keshillit bashkiak Shkoder", bashkëlidhur ju dërgojmë për shqyrtim relacionin projekt vendimin dhe dokumentacionin përkatës dhe kërkojmë nga ana juaj përfshirjen në rendin e ditës dhe miratimin e projekt vendimit të paraqitur: Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi, të pronave Ish Reparti Ushtarak Berdicë, Pasuria nr 10/127 dhe pasurinë në përgjegjësi të DPSHTRR nga prona shtetërore tek Bashkia Shkodër.

Bashkëlidhur gjeni projekt vendimin shoqëruar me relacionin dhe dokumentacionin përkatës:

Projekt Vendim 2 (dy) fletë.

Relacion 2 (dy) fletë.

Shkresë e Ministrinë se Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me lëndë 2 (dy) fletë

Shkresë e Bashkisë Shkoder nr.1080 prot, datë 21.01.2025 4 (katër) fletë

Shkresë e Bashkisë Shkoder nr.28425 prot, datë 16.12.2025 2 (tre) fletë

Shkresë e Bashkisë Shkoder nr 27598 prot, datë 21.01.2025 2 fletë

Duke Ju uruar punë të mbarë!

Me respekt

KRYETAR

Benet BECI

**ME VENDIM DELEGIMI
Z / KRYETAR
Onid BEJLERI**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E ASETVE DHE KADASTRES URBANE**

Nr. 1456/1 Prot

Shkodër, më 28/01 /2025

RELACION

**PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, TË
PRONAVE ISH REPARTI USHTARAK BERDICË, PASURIA NR 10/127 DHE PASURIA
NE PERGJESI TË DPSHTRR NGA PRONA SHTETËRORE TEK BASHKIA SHKODËR**

Drejtuar: Këshillit Bashkiak, Shkodër.

Të nderuar Këshilltarë!

Në funksion të përmbushjes së detyrave funksionale dhe objektivave të saj, bashkia Shkodër ka vlerësuar të domosdoshme nevojën për transferimin e disa pronave shtetërore në favor të saj.

Sa më sipër, paraqitet e nevojshme vijimi i kësaj procedure administrative për kalimin në pronësi të Bashkisë Shkodër të pronave me të dhëna si më poshtë :

- 1- Ish-Reparti Ushtarak Berdicë i ndodhur në Zonen Kadastrale nr. 1158 Nj. Administrative Berdicë Bashkia Shkodër e cila është nën përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes.
 - 2- Pasuria me nr.10/127 e ndodhur në Zonen Kadastrale 8592 Shkodër me sipërfaqe prej 23149 m² cila është në përgjegjësi administrimi të Repartit të FNSH Shkodër e paisur me dokument pronësie me nr 273, datë 19.12.2003.
 - 3- Pasuritë e ndodhura në Zonen Kadastrale 8591 Shkodër të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit dhe pozicionohen në pasuritë me Nr. 4/53; Nr. 4/222; Nr. 4/223; Nr. 4/296; Nr. 4/130; Nr.4/315; Nr. 4/652
2. Fusha e përdorimit të këtyre pasurive që kërkohen të transferohen nga Bashkia Shkodër do të jetë sipas percaktimeve të nenit 3 , të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 “*Per transferimin e pronave të paluajtshme publiketë shtetit në njësitë e qeverisjes vendore*”, të ndryshuar, do të jetë prona të cilat perdoren për kryerjen e funksioneve sipas parashikimeve të ligjeve në fuqi.

Në vijim të bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural Bashkia Shkodër është tashmë pjesë e programit “Qëndrueshmëria ndaj Klimes dhe Zhvillimit të Bujqësisë”. Në kuadër të këtij programi, përveç investimeve të tjera, parashikohet ndërtimi i Mikroqendrës Ushqimore. Konkretisht ndërtimi i një tregu për zonën e ultësirës së Shkodrës është pjesë e Planeve Strategjike të Bashkisë Shkodër për plotësim të rrjetit të tregtisë dhe krijim të hapsirave të posaçme për tregtim të produkteve lokale të fermerëve.

Sa më sipër është propozuar vendosja në dispozicion e një prone në zonën e Bërdicës me emërtimin Ish –Reparti Ushtarak Berdicë më qëllim realizimin e këtij Projektit.

Për bashkinë Shkodër realizimi i investimeve që kanë të bëjnë me krijimin e hapsirave të dedikuara për të rinjtë dhe posaçërisht për fëmijët është një nga prioritetet kryesore dhe duke qënë se kemi filluar një bashkëpunim me FSHZH për zbatim të projektit “Dua të Luaj” është e

nevojshme që të identifikojmë dhe vendosim në dispozicion të FSHZH dy prona publike në të cilat do të ndërtohen parqet multifunkionale të fëmijëve.

Nga vlerësimi i realizuar janë identifikuar dy zona përkatësisht pasuria e ndodhur në Zonën Kadastrale 8592 Shkodër me nr. 10/127 me sipërfaqe prej 23 149 m² cila është në përgjegjësi administrimi të Repartit të FNSH Shkodër dhe paisur me dokument pronësie me nr 273, datë 19.12.2003 dhe pasuritë e ndodhur në Zonën Kadastrale 8591 Shkodër të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit dhe pozicionohen në Nr. 4/53; Nr. 4/222; Nr. 4/223; Nr. 4/296; Nr. 4/130; Nr.4/315; Nr. 4/652.

Ky propozim vjen edhe në vijim të bashkëpunimit institucional me Ministrinë të cilat kanë pronat nën përgjegjësi administrimi, referuar korrespondencës shkresore.

- Shkresë e Ministrinë se Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me lëndë "Mbi realizimin e detyrave të Mikroqendres Ushqimore në kuader të projektit "Qëndrueshmëria ndaj Klimes dhe Zhvillimit të Bujqësisë", prot nr 8323/1, datë 23.12.2024.
- Shkresë e Bashkisë Shkoder nr.1080 prot, datë 21.01.2025 me lëndë "Kërkesë për transferim prone" drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes.
- Shkresë e Bashkisë Shkoder nr.28425 prot, datë 16.12.2025 me lëndë "Kërkesë për transferim prone" drejtuar Ministrisë së Brendshme.
- Shkresë e Bashkisë Shkoder nr 27598 prot, datë 21.01.2025 me lëndë "Kërkesë për transferim prone drejtuar Ministrisë së Infrastruktues dhe Energjisë

Vlerësojmë se ky propozim gjen mbështetje ligjore në dispozitat e ligjit nr.139, datë 17.12.2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 "Per transferimin e pronave të paluajtshme publike te shtetit në njësitë e qeverisjes vendore" i ndryshuar ,neni 3 ,nenit 5 ,dhe neni 17 ,VKM Nr.500, datë 14.08.2001 "Per inventarizimin e pronave te paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave ne njesite e qeverisjes vendore", I ndryshuar dhe Udhëzimit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit nr.15, datë 30.06.2003 "Per mënyren e paraqitjes nga njësitë e qeverisjes vendore të kërkesave për transferimin në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike".

Në zbatim të VKM nr.28, datë 27.1.2023 "Per përcaktimin e procedurave ë hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave për bashkëpunimin ndërmjet institucioneve " Kreu II, paraprakisht kërkon Vendimin e Keshillit Bashkiak dhe Ligjshmërinë nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Shkodër per trajtimin në vijim sipas procedurave të parashikuara me qëllim përfundimin e procedurave mbi transferimin e këtyre pasurive.

Sa me sipër i propozojmë Këshillit Bashkiak të miratojë propozimin : **Për miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi,të pronave Ish Reparti Ushtarak Berdicë,Pasuria nr 10/127 dhe pasurinë në përgjegjësi të DPSHTRR nga prona shtetërore tek Bashkia Shkodër.**

Duke ju falenderuar!

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z / KRYETAR

Onid BEJLERI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Nr. 1456/2 Prot

Shkodër, më 28.01.2025

PROJEKT VENDIM

Nr. _____, datë _____/2025

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI, TË PRONAVE ISH REPARTI USHTARAK BERDICË, PASURIA NR 10/127 DHE PASURINË NË PËRGJEGJËSI TË DPSHTRR NGA PRONA SHTETËRORE TEK BASHKIA SHKODËR

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës, _____/2025, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 8, pika 2, nenit 9 pika 1.2, te ligjit nr. 139, datë, 17.12.2015 "*Për Vetëqeverisjen Vendore*" të ndryshuar; nenit 3), nenit 5, nenit 17 të ligjit Nr.8744, date 22.02.2001 "*Per transferimin e pronave te paluajtshme publike te shtetit ne njesite e qeverisjes vendore*", të ndryshuar, VKM Nr.500, datë 14.08.2001 "*Për inventarizimin e pronave te paluajtshme shteterore dhe transferimin e pronave ne njesite e qeverisjes vendore* ", të ndryshuar; Udhëzimit Nr.15, date 30.06.2003 "*Për menyrën eparaqitjes nga njesite e qeverisjes vendore te kerkesave per transferimin ne pronesi te tyre te pronave te paluajtshme publike*, Shkresë e Ministrinë se Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me lëndë "Mbi realizimin e detyrave të Mikroqendres Ushqimore në kuader të projektit "Qëndrueshmëria ndaj Klimes dhe Zhvillimit të Bujqësisë" ,prot nr 8323/1,datë 23.12.2024,dhe sipas relacionit të paraqitur nga administrata e bashkisë Shkodër:

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesës për transferimin në pronësi të bashkisë Shkodër të pronave me këto të dhëna:
 - *Ish-Reparti Ushtarak Berdicë* i ndodhur në Zonen Kadastrale Nr.1158 Nj.Administrative Berdicë Bashkia Shkodër e cila është nën përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes.
 - *Pasuria me nr.10/127* e ndodhur në Zonen Kadastrale 8592 Shkodër me sipërfaqe prej 23149 m² cila është në përgjegjësi administrimi të Repartit të FNSH Shkodër e paisur me dokument pronësie me nr 273,datë 19.12.2003.
 - Pasuritë e ndodhura në Zonen Kadastrale 8591 Shkodër të cilat janë në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme te Shërbimeve të Transportit dhe pozicionohen në pasuritë me Nr. 4/53; Nr. 4/222; Nr. 4/223; Nr. 4/296; Nr. 4/130; Nr.4/315; Nr. 4/652.

perdoren për kryerjen e funksioneve sipas parashikimeve të ligjeve në fuqi.

3. Të ndiqen procedurat përkatëse sipas legjislacionin në fuqi, pas miratimit të kërkesës nga Këshilli Bashkiak Shkodër për ndryshimin e fushës së përdorimit të pasurive të sipërcituara duke bashkërenduar punën me ministritë përgjegjëse.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z / KRYETAR

Onid BEJLERI



Drejtoria Aseteve dhe Kadastres Urbane

Alban PREKA

Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Burimeve

Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse

Denis LESH


Drejtoria Juridike

Brikena LEQEJZA

Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit të

Qëndrueshëm Ekonomik

Bekim MEMA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E ASETeve DHE KADASTRES URBANE

Nr. 275PB Prot

Shkodër, më 03 / 12 .2024

Lënda: Kërkesë për transferim prone.

MINISTRISË SË INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISË

Adresa: "Rr. Abdi Toptani, Nr.1, Tiranë."

Znj. Belinda BALLUKU

MINISTËR I INFRASTRUKTURES DHE ENERGJISË

E nderuar znj. Ministre !

Duke vlerësuar mbështetjen e vazhdueshme që i keni dhënë pushtetit lokal, kërkojmë nga ana juaj të merrni në konsideratë kërkesën si më poshtë vijon:

Bashkia Shkodër me qëllim realizimin e detyrave funksionale dhe për të qene sa më afer qytetarëve në ofrimin e shërbimeve , në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit po punon për krijimin e një parku multifunksional për argëtimin e fëmijëve duke promovuar jetë të shëndetshme dhe aktive.

Bashkia Shkodër bën kërkesën pranë institucionit tuaj për transferimin nën administrim të bashkisë Shkodër të pasurisë së ndodhur në Zonen Kadastrale 8591 Shkodër e cila është në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit, transferuar me VKM nr 505, datë 30.8.2023 ” Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Drejtorisë Epërgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor të një pjese të pasurive Me Nr. 4/53; Nr. 4/222; Nr. 4/223; Nr. 4/296; Nr. 4/130; Nr.4/315; Nr. 4/652, në ZK 8591, Shkodër, dhe për disa shtesa në Vendimin nr. 226, Datë 23.4.2004, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Drejtorisë së Përgjithshme të shërbimit të Transportit Rrugor, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit ”.

Ndërtimi i parkut multifunksional mbështetet në korrespondencën ndërmjet bashkisë Shkodër dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit mbajtur me anë të shkresës me nr 19074.prot datë 25.09.2024 dhe e-mail i dates 12.03.2024.

Bashkangjitur po ju dërgojmë korrespondencën me Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe harten me vendndodhjen e pronës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, mbetemi në pritje të një përgjigje pozitive nga ana Juaj!

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

Z / KRYETAR

Onid BEJLERI



REPubLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8591026050
(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8591, Lloji i Pasurisë: TRUALL, Nr. i Pasurisë: 4/223, Sipërfaqja Totale 4893 m²,
(Nga të Cilat Truall 4893 m²; Ndërtesë 0 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale SH-O-5, Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia SHKODER, Rruga SALO HALILI, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Vlera e Pasurisë:

Fillestare 1 Leke (Akti Nr. _____, Dt. 01/04/2004), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B - TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: REPUBLIKA E SHQIPËRISË, Nr. Identifikimi/NIPT R00000000SH, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: Akteve të tjera sipas legjislacionit në fuqi, Nr. _____, Datë: 01/04/2004

Regjistruar: Nr. 01, Datë: 01/04/2004


**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____.*

B/1 - TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E ASETVE DHE KADASTRES URBANE

Nr. 28425 Prot

Shkodër, më 16.12.2024

Lënda: Kërkesë për transferim prone.

MINISTRISË SË BRENDSHME

Adresa: "Bulevardi Dëshmorët e Kombit", Nr.1, Tiranë.

Z.Ervin HOXHA

MINISTËR I BRENDSHËM

I nderuar z.Ministër !

Duke vlerësuar mbështetjen e vazhdueshme që i keni dhënë pushtetit lokal, kërkojmë nga ana juaj të merrni në konsideratë kërkesën si më poshtë vijon:

Bashkia Shkodër me qëllim realizimin e detyrave funksionale dhe për të qene sa më afer qytetarëve në ofrimin e shërbimeve , në bashkëpunim me Fondin Shqiptar të Zhvillimit po punon për krijimin e një parku multifunksional për argëtimin e fëmijëve duke promovuar jetë të shëndetshme dhe aktive.

Bashkia Shkodër bën kërkesën pranë institucionit tuaj për transferimin nën administrim të bashkisë Shkodër të pasurisë së ndodhur në Zonen Kadastrale 8592 Shkodër me nr.10/127 me sipërfaqe prej 23149 m² cila është në përgjegjësi administrimi të Repartit të FNSH Shkodër dhe paisur me dokument pronësie me nr 273,datë 19.12.2003.

Ndërtimi i parkut multifunksional mbështetet në korrespondencën ndërmjet bashkisë Shkodër dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit mbajtur me anë të shkreses me nr 19074.prot datë 25.09.2024 dhe e-mail i dates 12.03.2024.


Bashkangjitur po ju dërgojmë korrespondencën me Fondin Shqiptar të Zhvillimit dhe vertetim hipotekor të pronës.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në pritje të një përgjigje pozitive nga ana
Juaj!

KRYETAR

Benet BECI

**ME VENDIM DELEGIMI
Z / KRYETAR
Onid BEJLERI**



1

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KANA E RREGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
RRETHI SHKODER

VERTETIM
NGA DOKUMENTI HIPOTEKOR

Vertetohet se ne regjistrin hipotekor me nr. 273 (nje siperfaqe familiale)
 Date 19/12/03, figuron e regjistruar ne pronesi te:

Emri	Atesia	Mbiemri	Pjesa
<u>Reporci</u>	<u>73%</u>	<u>F. No. 340</u>	
<u>me</u>			
<u>Administracione te</u>			
<u>Administracione te Rendit Publik</u>			

Pasuria me nr. 10/127 e ndodhur ne Zonen Kadastrale 8342 me
 Siperfaqe 2314.9m² ne adresen 1 sfaqet e troshes e rrethit
e rrethit te vertetimit siperfaqe familiale

Kufizimet e pasurise jane:

V 10/25 L 10/23
 J 10/10, 10/126, 10/12 P 10/124, 10/125, 10/26

Origjina e regjistrimit te pasurise se paluajtshme:

Nr. hip _____	date: <u>1/1</u>	nr. hip. _____	date <u>1/1</u>
Nr. hip _____	date: <u>1/1</u>	nr. hip. _____	date <u>1/1</u>
Nr. hip _____	date: <u>1/1</u>	nr. hip. _____	date <u>1/1</u>

Barre mbi pasurine: 100%

Komente nga regjistruesi: _____

Ky vertetim eshte i vlefshem i shoqeruar me Harte q reguese Provizore

Zyra e Regjistrimit nuk garanton vertetimin e
 pronesise perpara perfundimit te Regjistrimit
 Pillestar sipas ligjit Nr. 7843, date 13.07.1994

Vertetimi i pronesise leshohet sipas
 kerkeses Nr. 3056
 Date 19/12/03 paraqitur ne ZRPP

Juiste i Presidenc
 Date: 22/11/05
 REGJISTRIMI I PASURIVE TE PALUAJTSHME
 RRETHI SHKODER
 KYRA E REGJISTRIMIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT
DREJTORIA E ASETVE DHE KADASTRES URBANE

Nr. 1080 Prot

Shkodër, më 21.01.2025

Lënda: Kërkesë për transferim prone.

MINISTRISË SË MBROJTJES

Adresa: "Rruga e Dibres", Tiranë.

Z.Pirro VENGU

MINISTËR I MBROJTJES

I nderuar z.Ministër !

Duke vleresuar mbështetjen e vazhdueshme që i keni dhënë pushtetit lokal në vijim të shkreses me nr 2477/1, me lëndë :Kërkesë për bashkëpunim”, kërkojmë nga ana juaj të merrni në konsideratë kërkesën si më poshtë vijon:

Bashkia Shkodër me qëllim realizimin e detyrave funksionale dhe për të qenë sa më afër qytetarëve në ofrimin e shërbimeve, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural po punon për realizimin e projektit ”Qëndrueshmëria ndaj Klimes dhe Zhvillimit të Bujqësisë”, projekt i cili ka për qëllim ofrimin e shërbimit ndaj qytetarëve të zonën së nën Shkodres dhe zhvillimin e bujqësisë nëpërmjet Mikroqendrës Ushqimore që parashikohet të ndërtohet.

Bashkia Shkodër bën kërkesën pranë institucionit tuaj për transferimin nën administrim të pasurisë *Ish - Reparti Ushtarak Berdicë* me sipërfaqe prej 131182.72 m² të ndodhur në Zonën Kadastrale, 1158 Berdicë Shkodër pasuri e cila pozicionohet në pasuritë me nr. 55/1,nr.320,nr.321,nr. 327/1 dhe nr.327/2.

Realizimi i projektit “Qëndrueshmëria ndaj Klimes dhe Zhvillimit të Bujqësisë” mbështetet në korrespondencën e mbajtur ndërmjet Bashkisë Shkodër me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural .

Bashkangjitur po ju dërgojmë korrespondencën me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ,nr.8323/1.prot datë 23.12.2024 dhe shkesen me nr 24771/,datë 31.05.2021 të Ministrisë së Mbrojtjes.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,mbetemi në pritje të një përgjigje pozitive nga ana Juaj!

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZYKRYETAR

Onid BEJLERI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 2477/ prot.

Tiranë, më 24.05 2021

Lënda: Kërkesë për bashkëpunim.

BASHKISË SHKODËR

Shkodër

Ministria e Mbrojtjes, me qëllim miradministrimin e pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes dhe, në funksion të organeve të qeverisjes vendore, për të plotësuar nevojat tuaja në projekte zhvillimore e social-kulturore, bashkëlidhur dërgon listën e pronave në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mbrojtjes, të cilat mund të shërbejnë për bashkinë tuaj.

Pasi të bëhet verifikimi dhe evidentimi i pronave, të cilat mund t'ju shërbejnë, në zbatim të Hgjut nr. 8744, datë 22.02.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, nga ana juaj përgatitet kërkesa për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit nga Ministria e Mbrojtjes te bashkia Shkodër.

Ministria e Mbrojtjes mbetet e gatshme për bashkëpunim.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

NË MUNGESË
DREJTORI I PËRGJITHSHËM I POLITIKAVE TË MBROJTJES

Florian Kalit



JENI IME, UDHËZIME, SHKRESA, KËRKESA
NR 8566 DATE 02.06 - 2021
DEPARTAMENTI I GA:
LËNDA:

SHËNIMET E TITULLARIT

25	427	Garnizon Ushtarak	Juban, Shkodër	16122,7	Nr.1303, datë 23.02.2010 dhe shkresa Nr.11134, datë 06.11.2012	KFT
26	428	Ish Repart Ushtarak Nr.1191	Luginë, Shkodër	43115	Nr.4307, datë 03.06.2010 dhe shkresa Nr.11134, datë 06.11.2012	KFT
27	429	Ish Repart Ushtarak	Berdicë, Shkodër	131182,72	Nr.1303, datë 23.02.2010 dhe shkresa Nr.11134, datë 06.11.2012	KFT
28	1225	Ish Batalion mitralier	Velipojë, Shkodër	20083,9		KFT
29	1227	Ish Repart Ushtarak	Zoetëknikë, Shkodër	38491		KFT
30	1228	Ish Repart Ushtarak	Kala, Shkodër	1682,66		KFT
31	1229	Ish Repart Ushtarak në rajonin e DK	Shkodër	96372,8		KFT
32	1230	Ish Repart Ushtarak	Kir - Pult, Shkodër	23873,95		KFT
33	1231	Ish Repart Ushtarak	Golem, Shkodër	14337,7		KFT
34	1232	Ish Repart Ushtarak	Grudë e Re, Shkodër	37936		KFT
35	1238	Ish Repart Ushtarak	Carinë, Oblik Shkodër	5794,75		KFT
36	1247	PVQ	Belaj Dajç Shkodër	3655,5		KFT
37	1268	Ish Qendër Stërvitore	Velipojë, Shkodër	1016,14		KFT
38	1316	Ish Komandë e FV	Tepe, Lagja Qaf Hardhi	3151		KFT
39	1318	Ish grup AKA dhe VK divizioni	Rrence, Shkoder	47217		KFT
40	1323	Ambient ish diviz.kembesoris e	Shkoder	37559,3		KFT

457421.741
4654203.480

456039.841
4654205.480




457421.741
4653313.780

456039.841
4653313.780

<https://geoportal.asig.gov.al>: ofron të dhëna
gjeohapësimore të ofruara nga autoritetet publike
përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e
autoritetit publik që i ka krijuar ato.

Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Nr. 8323/prot.

Tiranë, më 23.12.2024

Lënda: Mbi realizimin e ndërtimit të Mikroqendrës Ushqimore në kuadër të projektit "Qëndrueshmëria ndaj Klimës dhe Zhvillimit të Bujqësisë", dhe angazhimeve përgatitore për këtë qëllim.

VENI ME DËSHIRË, SHKRESA, KEM
NR. 28145 DATE 26.12.2024
DREJTUAR NGA
LËNDA

Drejtuar:

Z. BENET BECI

KRYETAR

BASHKIA SHKODËR
Rruga "13 Dhjetori" Nd.9, Hyrja 1, 4001

Shkodër

I nderuar Z. Kryetar,

Duke ju falënderuar për organizimin e takimeve dhe pritjes të përfaqësuesve të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) dhe ekipit të zbatimit të Projektit "Qëndrueshmëria ndaj Klimës dhe Zhvillimit të Bujqësisë (CRAD)", në vazhdim të komunikimit zyrtar në lidhje me mundësinë e realizimit të ndërtimit të Mikroqendrës Ushqimore MQU, vlerësojmë të nevojshme përmbushjen e disa angazhimeve të shprehura zyrtarisht të cilat do të mundësonin hapat e mëtejshëm për këtë qëllim. Për këtë kërkohet:

- 1) Sigurimin e certifikatës dhe kartelës së rifreskuar të pasurisë së trojeve për të dy pozicionet e propozuara.
- 2) Angazhimi paraprak dhe më pas i miratuar prej Këshillit Bashkiak që: pozicioni i zgjedhur prej MBZHR do të vihet në dispozicion për këtë qëllim dhe do të mbahet i ngurtësuar për një periudhë jo më pak se dy vjet nga data e miratimit.
- 3) Angazhimi nëpërmjet shkresës zyrtare nga ana e Bashkisë Shkodër për sigurimin me fondet e veta të:
 - a) energjisë elektrike;
 - b) ujit të pishëm;

c) shkarkimit të ujit të përdorur.

- 4) Sigurimi i zgjerimit të rrugës hyrëse dhe dalje nga rruga automobilistike për në vendndodhjen ku propozohet ndërtimi i MQU për sigurimin e lëvizjes së lirë të automjeteve dhe qytetarëve për të mundësuar funksionimin normal të aktiviteteve pa krijuar shqetësime në komunitet. Gjate vizitës në terren më datë 22 Nëntor përfaqësues të Bashkisë u angazhuan që të fillojnë komunikimin me autoritetin fetar për të bërë të mundur zgjerimin e rrugës duke kompensuar truallin e xhamisë me një truall në pjesën lindore të saj.

Në fillim te vitit 2025 MBZHR do të angazhojë kompaninë e konsulencës e cila në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse të cilat ju keni caktuar paraprakisht do të realizojnë studimin e fizibilitetit (hëshmërisë).

Në pritje të përgjigjes Tuaj.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Florenca Korbi

